

A COMPARISON OF NEGOTIATIONS IN BOSNIA AND HERZEGOVINA, KOSOVO AND MACEDONIA – DIFFERENCES AND SIMILARITIES IN THE NEGOTIATION PROCES AND THE IMPLEMENTATION OF PEACE AGREEMENTS

Qazime Sherifi

Mother Teresa University, Republic of North Macedonia, qazime.sherifi@unt.edu.mk

Abstract: This paper analyzes and compares the negotiations and the effectiveness of preventive diplomacy in three conflicts of the former Yugoslavia: in Bosnia and Herzegovina, Kosovo, and Macedonia. In each case, it evaluates the role of international actors in crisis management and conflict resolution. While Bosnia and Kosovo involve major international interventions and intensive diplomatic mediation, Macedonia presents a successful case of preventive diplomacy. The study highlights the differences in strategies employed by international actors, as well as their influence on the final peace outcomes. Using a comparative approach and analysis of key documents, the paper aims to contribute to the understanding of factors that shape the effectiveness of negotiations in different political and ethnic contexts.

Keywords: negotiations, international diplomacy, Bosnia and Herzegovina, Kosovo, North Macedonia, peace agreements, international intervention, conflict resolution, preventive diplomacy.

KRAHASIMI I NEGOCIATAVE NË BOSNJE E HERCEGOVINË, KOSOVË DHE MAQEDONI – DIFERENCAT DHE NGJASHMËRITË GJATË NEGOCIATAVE DHE IMPLEMENTIMIT TË MERREVESHJEVE TË PAQES

Qazime Sherifi

Mother Teresa University, Republic of North Macedonia, qazime.sherifi@unt.edu.mk

Abstrakt: Ky punim analizon dhe krahason negociatat dhe efektshmërinë e diplomacisë parandaluese në tri konflikte të ish-Jugosllavisë: në Bosnje e Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoni. Në secilin rast, ai vlerëson rolin e faktorit ndërkombëtar në menaxhimin dhe zgjidhjen e krizave. Ndërsa Bosnja dhe Kosova përfshijnë ndërhyrje të mëdha ndërkombëtare dhe ndërmjetësim intensiv diplomatik, Maqedonia paraqet një shembull të suksesshëm të diplomacisë parandaluese. Studimi thekson dallimet në strategjitë e aktorëve ndërkombëtarë, si dhe ndikimin e tyre në rezultatet përfundimtare të paqes. Duke përdorur qasje krahasuese dhe analiza të dokumenteve kyçe, punimi synon të kontribuojë në kuptimin e faktorëve që formësojnë efektivitetin e negociatave në kontekste të ndryshme politike dhe etnike.

Fjalë kyçe: negociatat, diplomacia ndërkombëtare, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, marrëveshjet e paqes, ndërhyrja ndërkombëtare, zgjidhja e konflikteve, diplomacia parandaluese.

1. HYRJE

Konfliktet ndëretnike në ish Jugosllavi gjatë viteve '90 dhe fillimit të viteve 2000, u bënë objekt i interesimit intensiv të Bashkësisë Ndërkombëtare. Bosnja e Hercegovina, Kosova dhe Maqedonia përbëjnë tri raste të dallueshme, por të ndërlidhura, ku negociatat dhe roli i faktorit ndërkombëtar në zgjidhjen e konflikteve u manifestuan në forma të ndryshme. Në të tri proceset, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian ishin aktorë kryesorë, duke ofruar mbështetje dhe drejtim në çdo fazë të negociatave. NATO kishte gjithashtu një rol të rëndësishëm në sigurimin e një zgjidhjeje dhe ruajtjen e paqes. Edhe Kombet e Bashkuara ishin një pjesë e rëndësishme e strukturës ndërkombëtare të mbikëqyrjes. Gjithashtu i rëndësishëm ishte edhe intensiteti dhe mënyra e përfshirjes ndërkombëtare.

Në Dejton, angazhimi i SHBA dhe NATO-s ishte i fuqishëm, duke përfshirë diplomacinë dhe prani të madhe ushtarake. SHBA dhe NATO luajtën rolin e udhëheqësit të negociatave dhe të garantuesve të implementimit të marrëveshjes. Richard Holbrooke, diplomati i SHBA, ishte i njohur për aftësinë e tij për të menaxhuar një mjedis të komplikuar dhe për të përmirësuar marrëdhëniet midis grupeve etnike. Angazhimi i NATO-s ishte gjithashtu i rëndësishëm, sepse trupat e NATO-s garantuan mbikëqyrjen e marrëveshjes dhe ruajtjen e paqes. Ky angazhim ndërkombëtar ishte esencial për ruajtjen e stabilitetit në një periudhë të brishtë pas luftës.

Në Rambuje, ndërhyrja ushtarake e NATO-s ishte e pashmangshme. Ajo përfshiu angazhimin e NATO-s dhe të SHBA-ve si ndërmjetësues kryesorë, megjithatë, ndërmjetësimi më i theksuar ishte nga BE dhe OKB. Negociatat u mundësuan nga presioni ndërkombëtar, veçanërisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian.

Pas refuzimit të Serbisë për të nënshkruar marrëveshjen, NATO ushtroi presion dhe ndërhyri ushtarakisht, duke i dhënë fund luftës dhe duke vendosur një administratë ndërkombëtare në Kosovë, e cila do të garantonte paqen dhe stabilitetin afatgjatë.

Ndërsa në Ohër ndërmjetësimi ishte më shumë politik dhe i mbështetur në dialog, pa përfshirë ndërhyrje ushtarake. Në Maqedoni, ndërmjetësimi i Bashkimit Europian dhe SHBA-ve ishte më i butë, dhe i fokusuar në krijimin e një marrëveshjeje politike dhe diplomatike, më shumë se sa në përdorimin e forcës. Ndërmjetësuesit ndërkombëtarë ndihmuan në gjetjen e një balance midis interesave të maqedonasve dhe shqiptarëve dhe mundësuan që reforma të thella të ishin të mundshme, përfshirë përfshirjen e shqiptarëve në administratën shtetërore dhe ruajtjen e unitetit të Maqedonisë.

2. DIFERENCAT DHE NGJASHMËRITË GJATË NEGOCIATAVE DHE IMPLEMENTIMI I MARRËVESHJEVE TË PAQES – DEJTON, RAMBUJE DHE OHËR

Në çdo nga këto shtete, ndërhyrja e faktorit ndërkombëtar ka qenë e domosdoshme për përpjekjet e zgjidhjes së konflikteve pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Megjithatë, roli i aktorëve ndërkombëtar dhe mënyra e ndërhyrjes kanë pasur dallime të mëdha, si në kohë, ashtu edhe në mënyrën e implementimit të proceseve paqësore. Ekspertë dhe analistë të ndryshëm kanë bërë krahasime e paralelizma për të gjetur çfarë kanë të përbashkët dhe ku ndryshojnë negociatat e Rambujesë nga ato të Dejtonit dhe të Ohrit. Pavarësisht se si Dejtoni, ashtu dhe takimi i Rambujesë dhe i Ohrit u janë kushtuar konflikteve që kanë të bëjnë me hapësirën e ish-Jugosllavisë, përsëri kanë disa ndryshime që nuk ka si mos të bien në sy.

Në rastin e Bosnjë-Hercegovinës, marrëveshja e Dejtonit (1995) ka shërbyer si një pikë kthese në përpjekjet për të përfunduar një luftë trevjeçare që kishte shkakuar gati 100,000 viktima dhe miliona të pastrehë. Negociatat e Dejtonit u zhvilluan në një moment kur palët në konflikt (Bosnjakët, Kroatët dhe Serbët) ishin të shkatërruara nga pasojat e luftës dhe shumë të motivuar për të arritur një marrëveshje që do t'i shpëtonte nga kërcënimi i vazhdimtë të dhunës. Ky kontekst ka luajtur një rol të madh në gatishmërinë e palëve për të pranuar kompromiset e nevojshme, edhe pse ato ishin shumë të dhimbshme për të gjithë aktorët përkatës. Negociatat u udhëhoqën nga Shtetet e Bashkuara, që luajtën një rol të rëndësishëm në udhëheqjen e procesit dhe në shpalljen e Marrëveshjes së Dejtonit. Diplomati amerikan Richard Holbrooke ka qenë një figurë kyçe në këto bisedime, duke negociuar drejtpërdrejt me liderët kryesorë të Bosnjës, Kroacisë dhe Serbisë për të arritur një marrëveshje që shpërndante autoritetin politik dhe administrativ në Bosnjë (Bajrami, 2011).

Marrëveshja e Rambujesë për Kosovën (1999), e cila pasoi pas një periudhë të dhunës etnike të shkakuar nga forcat serbe dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, u zhvillua në një kontekst krejtësisht të ndryshëm nga ai i Bosnjës. Në Rambuje, negociatat u zhvilluan para se lufta të kishte përfunduar dhe kur tensionet ishin të larta. Ndërsa negociatat e Dejtonit u zhvilluan pas një periudhe masive të shkatërrimit, ato të Rambujesë u zhvilluan në një periudhë kur lufta ishte ende aktive. Kjo i bëri negociatat shumë më të vështira, pasi palët kishin një gjendje më të tensionuar dhe një ndjeshmëri më të madhe për pozitat e tyre. Në këtë aspekt, ndërhyrja e aktorëve ndërkombëtarë ishte më urgjente dhe u përqendrua në kërkimin e një zgjidhjeje të shpejtë për të parandaluar eskalimin e mëtejshëm të dhunës. Diplomacia evropiane ka pasur një rol udhëheqës në këto negociata dhe ka marrë përgjegjësinë për organizimin e bisedimeve, ndërsa SHBA ka mbështetur këtë proces nëpërmjet ndikimit të saj politik dhe ushtarak (Lundestad, 2000). Gjithashtu, Grupi i Kontaktit, i cili përfshinte aktorë të rëndësishëm ndërkombëtarë si Shtetet e Bashkuara, Bashkimin Evropian dhe Rusia, ka luajtur një rol kritik në procesin e negociatave dhe në mbikëqyrjen e implementimit të marrëveshjeve.

Një dallim tjetër i rëndësishëm ndërmjet marrëveshjeve të Dejtonit dhe Rambujesë është se statusi i Bosnjës u përcaktua si përfundimtar, kurse ai i Kosovës mbeti i pasigurt dhe në status tranzitor. Në marrëveshjen e Dejtonit, Bosnja dhe Hercegovina u njohën si një shtet i unifikuar dhe sovran, pavarësisht se ky shtet kishte një ndarje të theksuar etnike (Serbët, Bosnjakët dhe Kroatët). Marrëveshja e Dejtonit ishte një kompromis i dhimbshëm, që shpërndante pushtetin dhe i jepte shumë autonomi entiteteve etnike, duke e bërë shtetin të papërfshirë dhe të fragmentuar (Rizvi, 2005). Në krahasim me Bosnjën, statusi i Kosovës u mbajt i paqartë për një periudhë të gjatë pas Rambujesë. Ky status u shpall si një "status tranzitor", i cili duhej të rishikohej pas një periudhe trevjeçare. Marrëveshja e Rambujesë nuk përmendi as termat "republikë" apo "krahinë", por thjesht përdori termin "Kosovë", duke lënë hapësirë për negociimin e një statusi të ardhshëm. Ky fakt ka pasur pasojat të mëdha për zhvillimet e mëvonshme, si shpallja e pavarësisë në vitin 2008 dhe njohja e kësaj pavarësie nga shumë shtete ndërkombëtare (Vickers, 2008).

Për dallim nga Bosnja dhe Kosova, ku ndërhyrja ndërkombëtare ka pasur një karakter më reaktiv, në Maqedoni aktorët ndërkombëtarë vepruan më herët, duke parandaluar një eskalim të madh të dhunës. Konflikti në Maqedoni në vitin 2001, i njohur si Lufta e Maqedonisë, ishte një përplasje ndërmjet forcave të ushtrisë maqedonase dhe grupeve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), që kërkonin të drejta më të mëdha për shqiptarët. Angazhimi

ndërkombëtar, veçanërisht nga BE-ja dhe NATO-ja, ishte i shpejtë dhe i drejtpërdrejtë, duke lehtësuar arritjen e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (2001), e cila arriti të ndalonte luftën dhe të krijonte mundësinë për një shoqëri më të integruar multietnike (Gashi, 2002). Po ashtu, përmes programeve për zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe digjitalizimin e arsimit në distancë, u kontribua në konsolidimin e bashkëjetesës dhe stabilitetit (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, 2020). Marrëveshja Kornizë ka qenë një dokument kyç për paqen në Maqedoni, duke krijuar një kornizë për të drejtat e shqiptarëve dhe duke e transformuar këtë shtet në një entitet më të qëndrueshëm. Roli i aktorëve ndërkombëtarë ka qenë vendimtar në këtë proces, dhe kjo ka bërë që Maqedonia të shpëtojë nga një luftë civile më e gjatë dhe më shkatërruese (Erlingsson, 2005).

Rëndësi të veçantë për zgjidhjen e shpejtë të konfliktit kishte edhe angazhimi në nivel të lartë. Fakti që Presidenti, Kryeministri dhe aktorët e tjerë kryesorë mund të kishin qasje ditë e natë deri te njerëzit kryesorë të NATO-s dhe BE-së, krijoi atmosferë mirëbesimi që u dëshmuua si e paçmueshme kur u paraqit nevoja për udhëheqje dhe negociata. Ndërsa ky angazhim mungonte në rastin e Bosnjë e Hercegovinës dhe Kosovës. Vullneti i njerëzve në nivelet më të larta për të mbajtur kontakte të drejtpërdrejta bëri që nismat e mëvonshme të kishin më teper gjasa për të dhënë rezultate. Kjo është arsyeja se pse Maqedonia u shpëtua.

Përderisa konflikti i vitit 2001, në mënyrë të arsyeshme e ka prishur mitin për Maqedoninë si "ishull i stabilitetit", zgjidhja e shpejtë e konfliktit pa shumë viktima është në kontrast të thellë me luftërat tjera në rajon. Marrëveshja kornizë e Ohrit, është dhënë si udhëzues për daljen nga konflikti dhe është dëshmuar si relativisht i suksesshëm. Shumë plane tjera paqësore në Bosnjë dhe Hercegovinë si dhe Kosovë, kanë pasur pozita shumë më të vështira fillestare. Është shumë më e lehtë të bëhet paqe pas luftimeve tetë muajshe dhe rreth 200 viktimave sesa pas luftimeve të gjata tre vite e gjysmë me mbi 100.000 të vdekur si në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Dallimi më i madh që e ka bërë paqen të jetë e qëndrueshme në Maqedoni ka qenë fakti që konflikti në esencë nuk ka qenë për ngadhënjimin e shteteve, por për ta fituar idenë e natyrës së shtetit. Ndonëse Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK) në fazat e hershme të konfliktit ka lëshuar disa deklarata, me të cilat sugjerohet agjenda e ndarjes, qëllimet ekëtitilla janë heshtur së shpejti dhe fokusi i vërtetë është vendosur tek të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni dhe jo te rindarja e kufijve. Në Kosovë dhe Bosnjë dhe Hercegovinë është diskutuar për vetë shtetin, me çka është vështirësuar shumë arritja e marrëveshjes për rindarjen e kufijve.

Në Maqedoni, për dallim nga Bosnja e Hercegovina dhe Kosova, përveç BE-së dhe NATO-s në terren dhe në nivel ndërkombëtar, edhe organizatat e tjera luajtën rol të rëndësishëm në tërë procesin. OSBE-ja, nëpërmjet kryesuesit të saj energjetik dhe efikas Mirçea Xhoana, Këshilli i Evropës, Tribunali Ndërkombëtar për Krime Luftë në ish-Jugosllavi, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, dhe individë si komisar i evropian Kris Paten etj, që të gjithë luajtën rol të madh në vendosjen e Maqedonisë në rrugë të drejtë. Gjithashtu, është për t'u theksuar roli që kanë luajtur reformat në sistemin arsimor dhe shoqëror për ruajtjen e kohezionit ndëretnik, sidomos në nivelin e arsimit të mesëm dhe për të rriturit (Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2025).

3. ROLI I FAKTORIT NDËRKOMBËTAR GJATË NEGOCIATAVE

Faktori ndërkombëtar ka luajtur një rol vendimtar në zgjidhjen e konflikteve në hapësirën e ish-Jugosllavisë, veçanërisht nëpërmjet angazhimit të drejtpërdrejtë në negociatat kryesore që synonin arritjen e paqes dhe stabilitetit rajonal. Rastet e negociatave në **Dejton (1995)** për Bosnjën dhe Hercegovinën, **Rambuje (1999)** për Kosovën dhe **Ohër (2001)** për Maqedoninë, paraqesin shembuj të qartë të ndërhyrjes së aktorëve ndërkombëtarë si SHBA, BE dhe NATO me kapacitetet e tyre si ndërmjetësues, garantues dhe herë-herë si presionues të palëve konfliktuozë.

Negociatat e Dejtonit, të mbajtura në bazën ushtarake Wright-Patterson në Ohio, SHBA, në nëntor 1995, ishin nën drejtimin e fuqishëm të Shteteve të Bashkuara, veçanërisht përmes ndërmjetësimit të diplomatit Richard Holbrooke. Ai ishte i njohur për aftësinë e tij për të menaxhuar një mjedis të komplikuar dhe për të përmirësuar marrëdhëniet midis grupeve etnike. Edhe angazhimi i NATO-s ishte gjithashtu i rëndësishëm, sepse trupat e NATO-s garantuan mbikëqyrjen e marrëveshjes dhe ruajtjen e paqes. Ky angazhim ndërkombëtar ishte esencial për ruajtjen e stabilitetit në një periudhë të brishtë pas luftës (Leloup, 2009). Marrëveshja e arritur shënoi përfundimin e luftës në Bosnje dhe krijimin e një strukture shtetërore të ndarë në dy entitete – Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republika Srpska – një model i kompromisit të ndërtuar mbi balancën etnike dhe ndërkombëtare (Chollet, 2005). Përfshirja e SHBA-së ishte vendimtare në sigurimin e pjesëmarrjes së palëve dhe në imponimin e një marrëveshjeje që nuk përfaqësonte plotësisht interesat e asnjërës palë, por që u pranua për shkak të presionit të bashkësisë ndërkombëtare dhe rrezikut të izolimit diplomatik dhe ekonomik (Power, 2002).

Konferenca e Rambujesë, e mbajtur në Francë në shkurt 1999, kishte për qëllim zgjidhjen e krizës së përshkallëzuar në Kosovë. BE dhe SHBA udhëhoqën përpjekjet për të ndërmjetësuar një marrëveshje midis delegacionit shqiptar të Kosovës dhe autoriteteve jugosllave. Ndërhyrja ndërkombëtare, ndonëse intensive, dështoi të sigurojë një marrëveshje të pranuar nga të dyja palët. Delegacioni kosovar nënshkroi marrëveshjen, por pala serbe refuzoi për shkak të parashikimit për vendosjen e forcave të NATO-s në territorin jugosllav (Caplan, 2005).

Ky dështim përfundoi me nisjen e bombardimeve të NATO-s kundër Jugosllavisë, duke treguar se ndërhyrja ndërkombëtare nuk ishte vetëm ndërmjetësuese, por edhe ushtarakisht e imponuar në rrethana të caktuara, kur diplomacia nuk prodhon rezultate (Daalder & O'Hanlon, 2000). Pas ndërhyrjes ushtarake të NATO-s, Bashkësia Ndërkombëtare në Kosovë ka pasur një ndikim të madh në stabilizimin e situatës, megjithatë pas shpalljes së pavarësisë, Kosova është përballur me sfida të mëdha në krijimin e institucioneve të qëndrueshme dhe mbështetjeve të komunitetit ndërkombëtar për integrimin në Organizata Ndërkombëtare (Gordon, 2008).

Në rastin e Maqedonisë, negociatat e Ohrit (2001) u zhvilluan pas një konflikti të shkurtër të armatosur midis forcave maqedonase dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Marrëveshja e Ohrit, e përkrahur fuqimisht nga BE dhe SHBA, kishte për qëllim adresimin e kërkesave të shqiptarëve etnikë për të drejta më të gjera politike, gjuhësore dhe administrative. Roli i faktorit ndërkombëtar në këtë rast u karakterizua nga një qasje e koordinuar dhe më fleksibile, duke promovuar dialog dhe reforma në vend të presionit ushtarak (International Crisis Group, 2001). Në Maqedoni, ndërmjetësimi i Bashkimit Europian dhe SHBA-ve ishte më i butë, dhe fokusuar në krijimin e një marrëveshjeje politike dhe diplomatike, më shumë se sa në përdorimin e forcës. Ndërmjetësuesit ndërkombëtarë ndihmuan në gjetjen e një balance midis interesave të maqedonasve dhe shqiptarëve dhe mundësuan që reforma të thella të ishin të mundshme, përfshirë përfshirjen e shqiptarëve në administratën shtetërore dhe ruajtjen e unitetit të Maqedonisë (Rizov, 2012). Marrëveshja e Ohrit ka ndihmuar në krijimin e mundësive për integrimin e shqiptarëve në jetën politike të Maqedonisë, por ka hatur vështirësi në implementimin e plotë të reformave për shkak të tensioneve dhe konflikteve të brendshme, duke dëshmuar vështirësitë që vijnë nga ndërhyrja ndërkombëtare pa një angazhim të qëndrueshëm dhe të thellë për implementimin e reformave (Rizov, 2012).

Marrëveshja e Ohrit u pa si një sukses i diplomacisë parandaluese, duke reflektuar mësimet e nxjerra nga dështimet e mëparshme në rajon. Përkrahja për decentralizimin, përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe dhe përfaqësimin e drejtë në institucionet shtetërore ishin thelbësore për stabilizimin afatgjatë të vendit (Reka, 2008).

4. EFEKTET E DILOMACISË PARANDALUESE NË BOSNJË DHE HERCEGOVINË, KOSOVË DHE MAQEDONI

Diplomacia parandaluese përkufizohet si përpjekje për të penguar shpërthimin e një konflikti të armatosur përmes masave të hershme diplomatike, politike dhe ekonomike (Lund, 1996). Ky koncept nënkupton jo vetëm ndërhyrje të menjëhershme në momente të krizës, por edhe ndërtimin e strukturave që parandalojnë rikthimin në dhunë.

Suksesi ose dështimi i diplomacisë parandaluese në këto tri raste varet nga disa faktorë kyç:

- Kohezioni ndërkombëtar dhe gatishmëria për ndërhyrje ;
- Kërkesat dhe bashkëpunimi i aktorëve lokalë;
- Mjetet në dispozicion, përfshirë sanksionet, ndërhyrjet paqësore ose forcën ushtarake;
- Legjitimiteti dhe kredibiliteti i aktorëve ndërkombëtarë ;
- Gatishmëria për të vepruar në faza të hershme të konfliktit dhe për të mbështetur zgjidhje gjithëpërfshirëse politike (Wolff, 2011).

Në Bosnje dhe Hercegovinë, shpërthimi i luftës më 1992, tregoi dështimin e diplomacisë parandaluese, për shkak të reagimit të vonuar të bashkësisë ndërkombëtare dhe mungesës së një strategjie të unifikuar. Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe OSBE fillimisht ofruan deklaratat diplomatike dhe ndihmë humanitare, por mungoi një ndërhyrje vendimtare në fazën e hershme kur tensionet ndëretnike ishin në rritje (Power, 2002). Mosuniteti ndërkombëtar dhe prioritetet e ndryshme strategjike mes aktorëve, si Franca, Britania dhe SHBA-ja, ndihmuan në zgjatjen dhe përshkallëzimin e konfliktit (Bellamy, 2002). Pasiviteti i OKB-së dhe mbështetja e kufizuar për forcat ndërkombëtare të ndërhyrjes u reflektua në pamundësinë për të parandaluar masakra si ajo e Srebrenicës në vitin 1995. Vetëm pas përshkallëzimit të krizës dhe ndërhyrjes ushtarake të NATO-s u arrit Marrëveshja e Dejtonit, që i dha fund konfliktit, por pas viktimitave masive dhe dëmeve të pallogaritshme (Power, 2002).

Në rastin e Kosovës, diplomacia parandaluese gjithashtu nuk arriti të parandalojë përshkallëzimin e dhunës gjatë viteve 1998–1999. Përpjekjet e hershme të OSBE-së dhe ndërmjetësimet ndërkombëtare si Misioni i Këshillit për Marrëdhënie të Jashtme nuk arritën të krijojnë mekanizma të besueshëm për de-eskalim (Touval, 1992). Raportet e hershme për shtypjen e të drejtave të shqiptarëve të Kosovës nuk u ndoqën nga masa konkrete ndërkombëtare, ndërkohë që regjimi serb intensifikonte dhunën ndaj popullsisë civile. Vetëm pas masakrës së Reçakut në janar 1999 dhe kolapsit të negociatave në Rambuje, NATO ndërhyri me fushatën ajrore, duke përfunduar konfliktin me forcë ushtarake (Power, 2002). Kjo ndërhyrje e vonuar konfirmoi se diplomacia parandaluese, pa mekanizma të zbatueshëm, nuk është e mjaftueshme për të ndaluar një regjim represiv të përshkallëzojë dhunën.

Maqedonia paraqet një rast të rrallë ku diplomacia parandaluese funksionoi. Në vitin 1992, Kombet e Bashkuara vendosën forca paqeruajtëse (UNPREDEP) për të monitoruar kufijtë dhe për të dekurajuar ndërhyrjen serbe. Ky ishte një prej rasteve të para ku OKB ndërhyri në një shtet paqësor për të parandaluar mundësinë e shpërthimit të dhunës (Lund, 1996). Përveç kësaj, OSBE dhe BE ndihmuan në ndërtimin e institucioneve demokratike dhe promovimin e

bashkëjetesës ndëretnike, veçanërisht pas Marrëveshjes së Ohrit më 2001, e cila u arrit me ndërmjetësimin e fuqishëm të BE-së dhe SHBA-së (Reka, 2008). Marrëveshja përfshiu decentralizimin e pushtetit, njohjen e gjuhës shqipe dhe përfaqësimin proporcional të shqiptarëve në institucione, duke i dhënë Maqedonisë një shans të rrallë për stabilitet afatgjatë.

Krahasimi i këtyre rasteve tregon se diplomacia parandaluese ka më shumë gjasa të jetë e suksesshme kur:

- Ndërhyrja është e hershme dhe e vendosur.
- Egziston konsensus mes fuqive kryesore ndërkombëtare.
- Ndihehen dhe zhvillohen institucionet lokale për të menaxhuar tensionet ndëretnike.

Bosnja dhe Kosova ofrojnë mësim të dhimbshme mbi çmimin e mosveprimit, ndërsa Maqedonia dëshmon efektivitetin e diplomacisë preventive kur ajo zbatohet në kohën e duhur (Bellamy, 2002; Richmond, 2005). Për të ardhmen, komuniteti ndërkombëtar duhet të investojë më shumë në paralajmërim të hershëm, diplomaci të besueshme dhe përfshirje të thellë strukturore në vendet me rrezik të lartë për konflikt.

5. KRAHASIMI I MODELEVE TË NDËRHYRJES NDËRKOMBËTARE DHE EFEKTSHMËRIA E TYRE

Ndërhyrjet ndërkombëtare në konfliktet e Ballkanit të viteve 1990 dhe fillim të viteve 2000 kanë ndjekur modele të ndryshme, që varen nga urgjenca e situatës, interesat strategjike të aktorëve ndërkombëtarë dhe kapacitetet institucionale në terren.

Në rastin e Bosnjës, ndërhyrja ndërkombëtare ishte e karakterizuar nga fragmentim institucional dhe mungesë koordinimi ndërmjet aktorëve si OKB, BE dhe NATO. Deri në vitin 1995, operacionet ishin më shumë simbolike dhe të kufizuara, përfshirë vendosjen e zonave të sigurta që dështuan të mbrojnë civilët (Power, 2002). Ndërhyrja vendimtare erdhi vetëm pas ndërhyrjes ajrore të NATO-s dhe negociatave intensive amerikane që çuan në Marrëveshjen e Dejtonit. Kjo ndërhyrje, megjithatë, krijoi një strukturë shtetërore shumë të ndërlikuar dhe të ndikuar fort nga mbikëqyrja ndërkombëtare (Bellamy, 2002).

Kosova përfaqëson modelin e ndërhyrjes ushtarake unilaterale, të udhëhequr nga NATO pa mandat të drejtpërdrejtë nga OKB, e cila ndodhi për të parandaluar një katastrofë humanitare (Reka, 2008). Pas ndërhyrjes, u vendos UNMIK si administratë ndërkombëtare që mori funksionet qeverisëse për një kohë të gjatë. Edhe pse ndërhyrja përfundoi me largimin e forcave serbe dhe kthimin e refugjatëve, tranzicioni drejt vetëqeverisjes ishte i gjatë dhe i ndërlikuar për shkak të mungesës së konsensusit ndërkombëtar mbi statusin final të Kosovës (Wolff, 2011).

Ndërhyrja në Maqedoni, ndryshe nga dy rastet e tjera, ishte e parakohshme dhe e koordinuar, duke përfshirë UNPREDEP, OSBE dhe më vonë BE-në dhe SHBA-në në rolin e ndërmjetësuesve në Marrëveshjen e Ohrit. Ky model i integruar përfshinte masa politike, monitorim ndërkombëtar dhe mbështetje për reforma institucionale që synonin shmangien e dhunës dhe ruajtjen e integritetit territorial (Lund, 1996; Richmond, 2005).

Ndërhyrja në Bosnje erdhi shumë vonë dhe me kosto të lartë njerëzore. Në Kosovë, ndërhyrja ishte më e shpejtë dhe vendimtare, por e kontestuar ndërkombëtarisht dhe me pasoja të zgjatura për statusin. Ndërsa në Maqedoni, diplomacia parandaluese dhe ndërhyrja e integruar ndërkombëtare ndihmoi në shmangien e një lufte të përmasave më të mëdha. Këto raste dëshmojnë se kohezioni institucional ndërkombëtar, legjitimiteti i veprimit dhe koordinimi mes aktorëve janë elementë kyç për suksesin e ndërhyrjes në konflikte.

6. KONKLUZION

Ky punim ka analizuar në mënyrë krahasuese ndërhyrjen dhe ndikimin e faktorit ndërkombëtar në tri raste të ndryshme të krizave në hapësirën e ish-Jugosllavisë: Bosnje dhe Hercegovinë (1995), Kosovë (1999) dhe Maqedoni (2001). Rezultatet tregojnë se ndërhyrjet ndërkombëtare, ndonëse të ngjashme në motivim – ndalimin e dhunës dhe stabilizimin e rajonit – kanë prodhuar rezultate të ndryshme për shkak të kohës së reagimit, mjetit të përdorur (ndërmjetësim, presion diplomatik apo ndërhyrje ushtarake) dhe karakterit të konfliktit në secilin rast. Marrëveshja e Dejtonit në Bosnje përfaqëson një shembull të ndërhyrjes së vonuar dhe të imponuar, që arriti të ndalte luftën, por krijoi një strukturë shtetërore të ndërlikuar dhe të fragmentuar, me pasoja afatgjata për funksionalitetin e shtetit. Ndërhyrja në Kosovë, pas dështimit të marrëveshjes së Rambujesë, e realizuar përmes forcës ushtarake të NATO-s dhe administrimit të gjatë ndërkombëtar, ka prodhuar një lloj paqeje të mbikëqyrtur, por me status të kontestuar ndërkombëtarisht. Ndërkaq, Maqedonia përbën një rast unik ku diplomacia parandaluese dhe veprimi i koordinuar i BE-së dhe NATO-s kontribuan në arritjen e Marrëveshjes së Ohrit, duke parandaluar përshkallëzimin në konflikt të hapur dhe duke vendosur bazat për bashkëjetesë etnike dhe stabilitet afatgjatë.

Analiza e këtyre tri rasteve nënvizon rëndësinë e veprimit të hershëm, të koordinuar dhe gjithëpërfshirës të faktorit ndërkombëtar në menaxhimin e krizave. Diplomacia parandaluese, si në rastin e Maqedonisë, ka rezultuar më efektive dhe më e qëndrueshme sesa ndërhyrjet e vonshme dhe të imponuara. Këto gjetje janë të rëndësishme për

studimin e ndërtimit të paqes dhe për politikëbërjen ndërkombëtare, sidomos në kontekste ku konfliktet etnike dhe tensionet ndërkombëtare mund të përshkallëzohen me shpejtësi.

REFERENCA

- Amaral, J. (2018). Do peace negotiations shape settlement referendums? The Annan Plan and Good Friday Agreement experiences compared. *Cooperation and Conflict*, 53(3), 365–386.
- Bajrami, A. (2011). *Negotiating the peace in Bosnia: A historical perspective*. *Journal of Balkan Studies*, 17(2), 134-152.
- Bakiner, O. (2019). Why do peace negotiations succeed or fail? Legal commitment, transparency, and inclusion during peace negotiations in Colombia (2012–2016) and Turkey (2012–2015). *Negotiation Journal*, 35(4), 471–513.
- Bellamy, A. J. (2002). *Pragmatic Solidarism and the Dilemmas of Humanitarian Intervention*. *Millennium*, 31(3), 473–497.
- Bell, C., Wise, L., Beaujouan, J., Epple, T., Forster, R., & Wilson, R. (2021). A globalised practice of local peace agreements. In C. Bell (Ed.), *Local Peace Processes* (pp. 7–15). The British Academy.
- Caplan, R. (2005). *Europe and the Recognition of New States in Yugoslavia*. Cambridge University Press.
- Chollet, D. (2005). *The Road to the Dayton Accords: A Study of American Statecraft*. Palgrave Macmillan.
- Daalder, I. H., & O'Hanlon, M. E. (2000). *Winning Ugly: NATO's War to Save Kosovo*. Brookings Institution Press.
- Dyrstad, K., Binningsbø, H. M., & Bakke, K. M. (2022). Wartime experiences and popular support for peace agreements: Comparative evidence from three cases. *Journal of Conflict Resolution*, 66(9), 1562–1588.
- Erlingsson, G. O. (2005). *The Ohrid Agreement and the future of ethnic relations in Macedonia*. *International Politics and Society*, 3, 19-36.
- Gashi, R. (2002). *The Ohrid Agreement: A peacebuilding effort in Macedonia*. *European Political Studies*, 11(1), 60-77.
- International Crisis Group. (2001). *Macedonia's Name: Why the Dispute Matters and How to Resolve It*. ICG Balkans Report No. 122.
- Lund, M. S. (1996). *Preventing Violent Conflicts: A Strategy for Preventive Diplomacy*. United States Institute of Peace Press.
- Lundestad, G. (2000). *Europe's role in the Balkans: A comparative perspective*. *Journal of European Integration*, 22(3), 305-319.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës.(2025). Koncepti për Arsimin e Mesëm për të Rritur.Republika e Maqedonisë së Veriut. Marrë nga <https://mon.gov.mk/al/content/?id=5904>
- Power, S. (2002). *A Problem from Hell: America and the Age of Genocide*. Basic Books.
- Reka, B. (2008). *The Ohrid Agreement: The Travails of Inter-ethnic Relations in Macedonia*. *Human Rights Review*, 9(1), 55–69.
- Richmond, O. P. (2005). *The Transformation of Peace*. Palgrave Macmillan.
- Rizov, M. (2012). Interethnic Relations and Policy Reforms in Macedonia: A Decade after the Ohrid Agreement. *Journal of Ethnopolitics*, 11(3), 321–345.
- Rizvi, G. (2005). *The Bosnian conflict: A struggle for peace and stability*. Cambridge University Press.
- Kmezić, M. (2020). Recalibrating the EU's Approach to the Western Balkans. *European View*, 19(1), 63–70. <https://doi.org/10.1177/1781685820913655>
- Rrahmani, B., & Belegu, M. (2023). Endless EU Facilitated - Mediated Dialogue Between Kosovo and Serbia. *Insight Turkey*, 25(2).
- Touval, S. (1992). *Mediation in the Yugoslav Wars: The Critical Years, 1990–1995*. St. Martin's Press.
- Vickers, M. (2008). *Kosovo: A short history*. Oxford University Press.
- Vuković, V. (2024). Emerging trends in peacebuilding: The case of Colombia. *Global Policy*.
- Wolff, S. (2011). *Conflict Management in Divided Societies: The Role of International Actors*. Routledge.
- Zupančič, R. (2018). EU peace-building in the north of Kosovo and psychosocial implications for the locals. *Journal of Balkan and Near Eastern Studies*, 20(4), 353–370. <https://doi.org/10.1080/19448953.2018.1504379>